



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:208410

Datë: 14.02.2025

Numri i dokumentit: 06853701

AC.nr.8373/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Fatmir Baloku, kryetar i kolegjit, Kujtim Pasuli dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A. B. (...), M. Z. (...), I. M. (...), S. I. (...) dhe Z. S.(...), të cilët sipas autorizimit i përfaqëson B. P., avokat në Vushtrri, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, për kompensimin në emër të pagës së 13-të, shpërblimit jubilar dhe shujtave, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.7549/21, të datës 27.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.02.2025, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, e parashtruar përmes përfaqësuesit nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.7549/21, i datës 27.07.2023, në pikën I dhe II të dispozitivit VËRTETOHET.

II. Pika III dhe IV e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.7549/21, të datës 27.07.2023, mbetet e pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.7549/21, të datës 27.07.2023, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve A. B. (...), M. Z.(...), I. M.(...), S. I. (...) dhe Z. S. (...), ashtu që DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, paditësve t'ua paguaj shumat si në vijim: - Paditësit të parë Paditësi A. B. (...), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018, 2019,2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 561.91 €, e në total, shumën prej 2,247.66 €. - Paditësit të dytë M. Z. (...), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018, 2019,2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 571.09 €, e në total, shumën prej 2,284.36 €, dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune në vlerë të 25 %, të një page mesatare të vitit 2020, shumën prej 174.07 €, apo shumën e përgjithshme prej 2,458.43 €. - Paditësit të tretë I. M. (...), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018 dhe 2019, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 571.90 €, e në total shumën prej 1,143.80 €. - Paditësit të katërt

S. I.(...), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018, 2019,2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 565.21 €, e në total, shumën prej 2,260.84 €. dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune në vlerë të 25 %, të një page mesatare shumën prej 142.00 €, apo shumën e përgjithshme prej 2,402.84 €. - Paditësit të pestë Z. S. (...), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018, 2019,2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 609.13 €, e në total, shumën prej 2,436.52 €, dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune në vlerë të 25 %, të një page mesatare të vitit 2020, shumën prej 174.07 €, apo shumën e përgjithshme prej 2,610.59 €. II. DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Drejtoria Përgjithshme, në Prishtinë, t'ju paguaj paditësve A. B. (...), M. Z. (...), I. M. (...), S. I. (...) dhe Z. S. (...), shumat e gjykuara si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, e cila do të llogaritet nga data 17.09.2021 kur është paraqitur padia në këtë gjykatë e deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet e kësaj procedure kontestimore, në shumën prej 724.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit. III. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë së paditësve, për kompensimin e shpërblimit jubilar përtej shumave të gjykuar si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për: M. Z. dhe Z. S. në shumën prej 110.93 €, për secilin, ndërsa në tërësi refuzohet kërkesa e paditësit për I. M. për kompensimin e shpërblimit jubilar në shumë prej 142.00 €, si dhe për kompensimin e shpërblimit të pagës së trembëdhjetë përtej shumës së gjykuar dhe atë për fundvitet 2020 dhe 2021e në shumën prej 1,143.80 €. Poashtu në tërësi refuzohen kërkesat e paditësve, me te cilat kanë kërkuar për ta detyruar të paditurën që paditësve t'ju paguaj në emër të shujtave ditore nga 3.00 € për çdo ditë të prezencës së paditësve në punë, për periudhën kohore 14.11.2018 e deri më datë 23.02.2022, apo për 740 ditë të punës dhe atë për secilin veç e veç, nga 2,220.00 €, si e pabazuar. IV. Hedhet poshtë kërkesa e paditësit A. B. për kompensimin e shpërblimit jubilar në vlerë prej 25 % të një page bazë si e parakohshme.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe duke marrë për bazë interesin juridik të parashtruesit të ankesës, konsiderohet se i njëjti aktgjykimin e ankimuar e ka goditur pjesërisht dhe atë vetëm sa i përket pikës I të dispozitivit (pjesës aprovuese të kërkesëpadisë), si dhe pikës II (vendosjes për shpenzimet e procedurës), me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje dhe të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësve, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pa themeltë dhe aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit A. B. (...), M. Z. (...), I. M. (...), S. I. (...) dhe Z. S. (...), përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 17.09.2021 kanë ushtuar padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, shpërblimit jubilar dhe

shujtave, me detaje si në padi, të precizuar sipas parashtrësës së dt.21.03.2022, me detaje si në parashtrësë.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: *‘Kur gjykata, pasi ti arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë’*, andaj gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore ka nxjerrë aktgjykim pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që ka vlerësuar se në rastin konkret kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, pasi që bazohet në udhëzimet administrative me numër 02/2018 dhe 01/2021 të Policisë së Kosovës, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, andaj ka nxjerrë aktgjykimin me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marrë duke u bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, ndërsa vendimin mbi kamatën gjykata e shkallës së parë e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: në mes të palëve ndërgjyqëse rezulton se nuk ishte kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimet e punësimit për paditësin e parë me nr. të referencës, i datës 22.04.2021, për paditësin e dytë me nr. të referencës, i datës 22.04.2021, për paditësin e tretë me nr. të referencës, i datës 19.05.2017 si dhe me nr. të referencës, i datës 28.03.2019, për paditësin e katërt me nr. të referencës, i datës 20.04.2021, dhe për paditësin e pestë me nr. të referencës, i datës 26.04.2021. Nga vërtetimet e punësimit të cekura më lartë gjykata konstatoi se paditësi i parë e ka filluar punën te e paditura me datë 07.04.2003, aktualisht i ka mbi 20 vite përvojë dhe realizon pagë mujore, në shumë prej 563.25 €, paditësi i dytë e ka filluar punën te e paditura me datë 18.09.2000, aktualisht i ka mbi 22 vite përvojë pune dhe realizon pagë mujore në shumë prej 571.09 €, paditësi i tretë ka punuar te e paditura nga data 18.09.2000 e deri me datën 25.04.2019, dhe gjithsej i ka pasur 18 vite përvojë pune dhe derisa ka punuar ka realizuar pagë mujore në shumë prej 615.24 €, paditësi i katërt e ka filluar punën te e paditura me datë 15.04.2002, aktualisht i ka mbi 22 vite përvojë pune dhe realizon pagë mujore në shumë prej 565.21 €, dhe paditësi i pestë e ka filluar punën te e paditura me datë 22.05.2000, aktualisht i ka mbi 23 vite përvojë pune dhe realizon pagë mujore, në shumë prej 609.13 €. Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (tani e tutje UA nr.02/2018), për kërkesat e aprovuara të paditësve, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13-të, për vitet 2018, 2019 dhe 2020, ndërsa për kërkesën e paditësve për kompensimin e pagës së 13-të, për vitin 2021, duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (tani e tutje UA nr.01/2021). Sa i përket kërkesave të paditësve që kanë të bëjnë me kompensimin e shpërblimit jubilar prej 25 %, të pagës bazë, për çdo vit jubilar, për vitet 2018, 2019 dhe 2020, zbatohet neni 29 paragrafi 5 i UA nr.02/2018, në të cilin përcaktohet se: “Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”. Ndërsa për kërkesat e paditësve që kanë të bëjnë me kompensimin e shpërblimit jubilar prej 25%, të pagës bazë, për çdo vit jubilar, për vitin 2021, zbatohet neni 30 paragrafi 5 i UA nr.01/2021, në të cilin përcaktohet se: “Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”. Nga interpretimi i dispozitave të cituara më lartë të UA nr. 02/2018 dhe UA nr. 01/2021, të nxjerra nga e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës,

gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, sepse paditësit gëzojnë të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitojnë si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësit, të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës si dhe nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se të gjithë paditësit, kanë vlerësim të kënaqshëm të performancës dhe të njëjtëve nuk u është shqiptuar ndonjë masë disiplinore gjatë këtyre viteve. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësve për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj ndonjërit prej paditësve. Gjykata, vlerësoi se paditësit të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë, u takon shpërblimi jubilar prej 25 %, të pagës mesatare, bazuar në nenin 29 paragrafi 5 të UA nr.02/2018 dhe nenin 30 paragrafi 5 të UA nr.01/2021, pasi që të njëjtit i kanë arritur vitet jubilarë të përvojës së punës, duke i plotësuar kushtet ligjore nga udhëzimet administrative në fjalë. Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fundviteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021, gjykata mori për bazë vërtetimet e punësimit për secilin paditës veç e veç, e nga të cilat rezulton se paditësi i parë realizon pagë mujore, në shumë prej 563.25 € andaj të njëjtit për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, i takon shuma prej 2,253.00 €, por Gjykata ia aprovoi shumën prej 2,247.66 €, aq sa ishte kërkesa e paditësit duke qenë se e njëjta është e kufizuar të vendos brenda kufijve të kërkesës së palës, paditësi i dytë realizon pagë mujore, në lartësi prej 571.09 €, andaj të njëjtit për vitet e cekura si më lartë, i takon shuma prej 2,284.36 €, paditësi i tretë ka realizuar pagë mujore, në lartësi prej 615.24 € andaj të njëjtit për vitet 2018 dhe 2019, i takon shuma prej 1,230.48 €, por Gjykata ia aprovoi shumën prej 1,143.80 €, duke pasur parasysh kërkesën e paditësit për secilin vit veç e veç, pasi që e njëjta është e kufizuar të vendos brenda kufijve të kërkesës së palës, paditësit të katërt realizon pagë prej 565.21 €, andaj të njëjtit për vitet e cekura si më lartë, i takon shuma prej 2,260.84 € dhe paditësi i pestë realizon pagë në lartësi prej 609.13 € dhe të njëjtit për vitet e cekura si më lartë, i takon shuma prej 2,436.52 € ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Për përcaktimin e lartësisë së shpërblimit jubilar, Gjykata mori për bazë të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, të parashtruara me datë 15.06.2022 dhe me datë 08.02.2023, sipas kërkesave të gjykatës të datës 08.06.2022 dhe datës 07.02.2023, për pagën mesatare tek e paditura, nga e cila rezulton se paga mesatare neto te e paditura, në vitin 2018 ishte 566.30 €, në vitin 2019 ishte 594.40 €, në vitin 2020 ishte 696.30 €, në vitin 2021 ishte 642.50 € dhe në vitin 2022 ishte 617.90 €. Meqenëse paditësi i dytë dhe i pestë, vitet jubilarë të përvojës së punës i kanë arritur në vitin 2020, gjykata vlerëson se këtyre paditësve ju takon secilit nga 174.07 €, e që paraqet 25 %, e pagës mesatare tek e paditura, për vitin 2020. Paditësi i katërt vitin jubilar e ka arritur në vitin 2022, andaj i takon shpërblimi jubilar në lartësi prej 154.47 €, e që paraqet 25 %, të pagës mesatare për vitin 2022, porse gjykata ia ka njohur shumën prej 142.00 €, duke marrë parasysh lartësinë e kërkesës së vet paditësit për këtë lloj kompensimi, *(duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi)*.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës dhe prezenca në punë tek e paditura, përkatësisht në institucionin ku punon dhe lartësia e pagës bazë, për çka edhe me rastin e vendosjes drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 398 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsyeje se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e pagës së trembëdhjetë është e rregulluar me dispozita të Ligjit për Policinë e Kosovës nr.04/L-076 nenet 44 dhe 45 dhe Udhëzimeve Administrative nr.02/2018 dhe 01/2021 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, konkretisht të nenit 29 par.2 i cili përcakton të drejtën për pagën e 13-të kur kemi të bëjmë me vlerësim të kënaqshëm, në të cilin nën shprehimisht parashihet që: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*. Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjygjëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se paditësit janë aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, për çka edhe drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve dhe detyruar të paditurën që secilit paditës t’ua shpërblejë (kompensojë) pagat mujore në emër të pagës së 13-të, për periudhën dhe shumën e specifikuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, mbi bazën e vlerësimit të performances, të provuara përmes provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Tutje, sipas nenit 29 paragrafi 5 i UA nr.02/2018, përcaktohet se: *“Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”,* dhe sipas nenit 30 paragrafi 5 i UA nr.01/2021, po ashtu përcaktohet se: *“Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”*. Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjygjëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se paditësve M. Z., S. I. dhe Z. S. ju takon e drejta për shpërblimin jubilar prej 25 % të pagës mesatare, në shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, pasi që të njëjtit i kanë arritur vitet jubilarë të përvojës së punës, duke i plotësuar kushtet ligjore nga udhëzimet administrative të cilat kanë qenë në fuqi. Kjo çështje është sqaruar edhe përmes Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër 213/2023 të datës 09.10.2023, ku përcaktohet e drejta e personelit të policisë në kompensimin e pagës jubilarë me plotësimin e kushteve ligjore si më lartë.

Sipas Gjykatës së Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që personelit të policisë që kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase

disiplinore brenda vitit përkatës bazuar në udhëzimin Administrativ numër 02/2018 i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018 si dhe Udhëzimi Administrativ 01/2021 i cili ka hyrë në fuqi me datë 29.09.2021 i cili e ka shfuqizuar Udhëzimi Administrativ nr.02/2018, mirëpo sipas kësaj gjykate, personeli i policisë kanë të drejtë që edhe për vitin 2021, të përfitojnë shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse plotësohen kushtet e theksuara si më lartë, për arsye se neni 29 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, ka qenë në fuqi deri më datën 29.09.2021, dhe ka qenë i karakterit detyrues, sipas të cilit punëdhënësi ka qenë i obliguar që edhe për vitin 2021, të planifikojë mjetet buxhetore, ndërsa është i papranueshëm çdo arsyetim eventual për mungesë të mjeteve buxhetore. Kjo çështje është sqaruar edhe përmes Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër 213/2023 e datës 09.10.2023, ku përcaktohet e drejta e personelit të policisë në kompensimin e pagës së trembëdhjetë me plotësimin e kushteve ligjore si më lartë.

Gjykata e Apelit, pretendimin ankimor të të paditurës se kërkesëpadia e paditësve është parashkruar, nuk e mori parasysh, pasi që sipas shkresave të lëndës rezultoi se e paditura nuk është thirrur në institutin e parashkrimit gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore në shkallë të parë (*përmes përgjigjes në padi*), por vetëm në ankesën e parashtruar në gjykatën e shkallës së dytë. Andaj, bazuar në nenin 180 paragrafi 3 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Prapësimi i parashkrimit dhe prapësimi me qellim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë”*, për çka edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka mundur të marrë parasysh këtë pretendim të palës ankuese.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e nenit 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Meqë, aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur me ankesë në pikën III dhe IV të dispozitivit të tij nga pala me interes juridik, gjykata e shkallës së dytë, duke iu përmbajtur kufizimit ligjor të mjetit juridik (kufinj të ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar), sipas nenit 194 të LPK-së, këtë pikë të aktgjykimit të ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
AC.nr.8373/23, me datë 13.02.2025

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v